**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

# V E N D I M

Nr.72, datë 10.11.2006

**PËR**
**TRANSFERIM FONDESH**
**NË BUXHETIN E DREJTORISË NR.1 DHE NR.2 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 19, pika 9, neni 32, gërma "dh", ndryshuar me Ligjin Nr.9208, datë 18.3.2004, Ligjit Nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin e buxhetit të shtetit", ndryshuar me Ligjin Nr.8871, datë 29.3.2002, Udhëzimit Nr.342, datë 21.2.2006 "Për zbatimin e buxhetit të pushtetit vendor për vitin 2006", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.15, datë 27.3.2006 "Për miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2005 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2006", pas relacionit të paraqitur nga drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë një shtesë në Buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit në investime në shumën prej 2.475.000 lekësh për financimin e objektit "Blerje ndriçuesish".

2. Të miratojë një shtesë në Buxhetin e Drejtorisë Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit në investime në shumën prej 44.748.000 lekësh për financimin e objektit "Blerje pllakash për sistemimin e pjesës së mbetur të Bulevardit "Dëshmorët e Kombit".

3. Efektet financiare të pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi do të përballohen duke pakësuar në të njëjtën shumë fondin e investimeve për objektin "Rikonstruksioni i Bulevardit "Dëshmorët e Kombit".

4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit dhe Drejtoria Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**